

## **Dita Botërore e Hemofilisë 17 prill**

Çdo vit në 17 prill, në të gjithë botën kujtohet Dita Botërore e Hemofilisë. Kjo bëhet për të rritur ndërgjegjësimin e popullatës mbi Hemofilinë dhe sëmundjet hemorragjike të trashëgueshme të gjakut. Kjo datë është zgjedhur në kujtim të datëlindjes së themeluesit të saj, Frank Schnabel.

### **Hemofilitë**

Jane çrregullime të mpiksjes së gjakut (koagulopati) të lindura, të trashëgueshme kryesisht nga nëna tek djemte (recessive e lidhur me kromozomin X).

Hemofilitë shkaktohen në 80% të rasteve nga deficioni i faktorit të VIII koagulues, dhe quhet Hemofilia A, por egziston dhe Hemofilia B nga deficioni i faktorit të IX koagulues, apo deficioni i faktorit të XI dhe Hemofilia vaskulare.

Klinikisht nuk ka dallime mes dy formave kryesore, Hemofilisë A dhe B, por vetëm egzaminimet laboratorike tregojnë mungesën e njerit prej faktoreve të mpiksjes së gjakut.

Shenjat e para të sëmundjes mund të vihen re që në egzaminimet e para që i behen të porsalindurit, ku vihen re hematoma të nënlekures apo hemorragji pas një gervishtjeje të vogël që zgjat për disa ore. Në moshën me të rritur, femijet paraqesin hemorragji pas çdo demtimi fizik të hundës, dhembëve, kyçeve, lekures apo muskujve si dhe prani të gjakut në urinë, të vjellës dhe jashtëqitje.

Ka forma të lehta, të mesme dhe të rënda.

Parandalimi i plagosjeve qysh në vegjëli është sfida më e madhe për familjarët e këtyre femijeve. Shtypja mbi plage dhe ftohja e saj menjëherë, duhet të pasohet me trajtimin zëvendësues të faktorit koagulues që mungon dhe parandalimin e dhimbjeve dhe hemorragjive vdekjeprurëse. Terapia zëvendësuese bëhet me koncentrat të faktorit koagulues të manget ose të plazmës të freskët, të ngrirë. Tek këta pacientë nuk këshillohet përdorimi i medikamenteve që pengojnë veprimtarinë normale të trombocitëve si Aspirina.

Drejtohuni tek mjekët hematologë për t'ju informuar më tej për format, parandalimin dhe trajtimin e kësaj sëmundjeje.